## IV. Shenimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

### A. Informacion i Përgjithshëm

Shoqeria " Valtelina" sh.p.k eshte regjistruar si person juridik, ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuara Sh.p.k ,date16/07/1992.
Adresa: Tirane Kashar Autostrada Tirane-Durres, Km. 4, ZK. Nr. 2679, Pasuria 28/21
NIPT: **J61923012V**
*Objekti i kesaj shoqerie eshte: Perpunim, paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumice dhe pakice e mallrave, sipermarrja dhe sherbimi ne fusha te ndryshme; kryerje e transaksioneve ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, kryeja e veprimtarive dhe/ose pjesemarrja ne çdo veprim ose aktivitet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, apo çdo veprimtari ne lidhje me to, dhe çdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin Shqiptar.*
Kapitali i nenshkruar i saj eshte 300,000,000 Leke, 100 pjese me vlere nominale 3,000,000 leke /pjese.
*Numri i punonjesve: 68 , për vitin 2019:*

### B. Permbledhje e Politikave Kryesore Kontabel

#### 1. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara , sipas kostos historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohen ndryshe ne se ka te tilla. Monedha funksionale është LEK-u shqiptar ("LEK"), valutat e huaja jane konvertuar ne Leke.

***Bazat e Ndërtimit të Pasqyrave Financiare***

Pasqyrat finanaciare jane pergatitur sipas Standarteve Kombetare te kontabilitetit (SKK-ve), përbëhen nga pozicionet financiare, të ardhurat dhe shpenzimeve, pasqyra e fluksit të parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital si dhe shënimet shpjeguese.

***Konvertimi ne Monedha te Huaja***

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

| | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Kursi I kembimit | | |
| Euro/Leke | 121.77 | 123.42 |
| USD/Leke | 108.64 | 107.82 |

***Biznesi ne vijimesi***

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit te saj për një të ardhme të parashikuar gjate.
Me 31 Dhjetor 2019 vlera e aktiveve afatshkurtra eshte 788,607,743 Lek, vlera e detyrimeve afatshkurtra te shoqerise 255,925,853 Leke, perkatesish me 31 Dhjetor 2018 jane 824,851,211 Lek:



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

255,460,842 leke gje e cila paraqet nje siguri ne lidhje me aftesine e shoqerise per te pasur nje biznes ne vijimesi.
Ne jemi zoteruesit ligjor dhe perfituesit e kapitalit aksioner te shoqerise "Valtelina" sh.p.k. Eshte qellimi yne qe ne te vazhdojme te mbajme kete pjesmarrje ne shoqeri
Eshte ne interesin tone qe shoqeria dhe deget e saj te plotesojne detyrimet e tyre financiare ne cdo kohe. Eshte qellimi dhe politika jone t'i sigurojme shoqerise gjithe mbeshtetjen qe mund te nevojitet per te mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit ne nivele te tilla qe te permbushi detyrimet e saj ne perputhje me parimin e vijimesise te pershtatshem per ate aktivitet qe ajo kryen.

***Krahasueshmëria***

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.Të dhenat krahasuese pasqyrojne gjendjen e pozicionit finaciar te shoqerise ne 31 Dhjetor 2018.

## 2. Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë te shoqerise përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

***Njohja Fillestare***

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.
Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

***Njohja e Metejshme***

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

***Paraja dhe Ekuivalentet***

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvleresimet.

***Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme***

Llogarite e arketueshme tregetare dhe te tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlere nominale te pakesuar nga zbritjet e nevojshme per shuma qe jane vleresuar te pambledhshme.Vleresimi i shumave te pambledhshme bazohet ne gjykimin e drejtimit.

***Llogari të Pagueshme***

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar.

***Huatë të Dhëna dhe të Marra***

*Huate e Dhena*:Huate e arketueshme jane aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuara ne nje treg aktiv.Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifat ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit(NEI). Efekti i tyre perfshihet ne rezultatin financiar.
*Huate e marre*:Huatë (detyrime financiare), jane njohur fillimisht me vleren e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me vleren e amortizuar.Shpenzimet interesi te llogaritur me normen interesit efektive (NEI) pasqyrohen ne rezultat..
Norma e interesit efektive eshte Norma që skonton saktesisht vlerat e ardhshme te parave gjate viteve te planifikuara te detyrimit financiar ose kur eshte e pershtatshme, ne nje peridhe me te shkurter.



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat jane aktive që kerkojne domosdoshmerish nje periudhe te madhe kohe per t`u bere gati per perdorimin e tyre perfundimtar ose per shitje mund ti shtohen kostos se ketyre aktiveve deri ne momentin qe keto aktive jane kryesisht gati per tu perdorur ose shitur.

***Netimi i Instrumentave Financiare***

Aktivet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet ne bilanc nese, dhe vetem nese ka nje te drejte te detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe ekziston mundesia per të shlyer në shumen neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njekohesisht.

***Zhvleresime te Aktiveve Financiare***

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje (pas njohjes se tij fillestare) kane efekte negative ne flukset e ardhshme te parase që parashikohet të burojnë prej atij aktivi.Veshtiresite e konsiderueshme financiare te debitorit, propabiliteti qe debitori do te falimentoje apo nje riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet ne pagesa konsiderohen si tregues qe nje llogari e arketueshme eshte e zhvleresuar.

***Çregjistrimi***

Aktivet financiare se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojne, skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

***Transaksionet me palet e lidhura***

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter.

## 3. Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te tërthorte) si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar per te cilen ka mundesi qe te krijohen nje rrjedhe burimesh te nevojshme per te permbushur detyrimin dhe kur nje perllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit mund te llogaritet. Provigjionet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi per nevojen e nje rrjedhe burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjionet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht.

Pasivet dhe aktivet e kushtezuara nuk njihen, por vetem paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare te ndermjetme kur jane materiale.

## 4. Qiratë

Qirate klasifikohen si qira financiare ose qira operative qe ne fillirnin e qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me me te voglen midis vleres se drejte te aktivit dhe vleres aktuale te pagesave minimale te qirase ne daten e manjes. Kosto financiare paraqet diferencen midis detyrimit total te qirase dhe vleres se drejte te aktivit. Kostot financiare regjistrohen ne pasqyren permbledhese te te ardhurave &shpenzimeve gjate kohezgjatjes se qirase me norma interesi te aplikueshme mbi balancen e mbetur te detyrimeve.Shoqeria nuk ka qira financiare.

## 5. Inventaret

Inventaret regjistrohen ne konatbilitet me kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e inventarit ne vendin e percaktuar.Ne rastin e prodhimit te produkteve, ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese.Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda e kostos mesatare.

SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

## 6. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t)

*Njohja dhe Matja* :Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM-ve qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me koston e marrjes ose te prodhimit te tyre.Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e aktiveve ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

*Njohja Mepashsme:* AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvleresimi.

Në se një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet kostos së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të kostos aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

*Amortizimi:*Per llogaritjen e amortizimit te AAM-ve njesia ekonomike ka percaktuar si metode normat fiskale per amortizimin e aseteve.

| Llojet e Aktiveve te Qendrueshme | Normat e aplikuara | Metoda e aplikuar |
|---|---|---|
| Makineri dhe pajisje | 20% | Me vlere te mbetur |
| Mjete transporti | 20% | Me vlere te mbetur |
| Mobilje dhe Orendi | 20% | Me vlere te mbetur |
| Te tjera | 20% | Me vlere te mbetur |
| Pajisje Informatike | 25% | Me vlere te mbetur |
| Ndertesa | 5% | Me vlere te mbetur |

Llogaritja e amortizimit te AAM-ve te hyra gjate vitit behet duke filluar nga data e muajit pasardhes.

Tokat dhe Investimet ne process nuk amortizohen,

*Ç`regjistrimi:*Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk pritet me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

*Zhvleresimi (Renia ne vlere):*Shoqeria nuk vlereson ne daten raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet.

## 7. Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivet afatgjata jomateriale perfshijne liçensat, te drejtat per perdorim dhe emri i mire.

*Njohja dhe Matja:* Liçensat, te drejtat e perdorimit te cilat perftohen nga shoqeria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi, nese ka.

*Shpenzimet Mëpasshme:*Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.

*Amortizimi:*Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim. Jetegjatesia e parashikuar e aktiveve per periudhat aktuale dhe krahasuese eshte si me poshte:

*Zhvleresimi (Renia ne vlere):* Shoqeria nuk vlereson ne daten raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet.



Impex shpk SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

## 8. Të Ardhurat&Shpenzimet

***Te Ardhurat***

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa.Te ardhura matet me vlere te drejte te mallit/sherbimit te shitur neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

***Shpenzimet***

Shoqeria njeh shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me kryerjen e tyre ne daten e raportimit.Shpenzimet paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyres se tyre, çka kerkon gjykim te konsiderueshem nga drejtimi i Shoqerise.

***Te Ardhurat dhe shpenzimet Financiare***

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv.

***Tatimi mbi Fitimin***

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual.Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 dhe 2017 paraqiten me poshte:

| | 31.12.2019 | 31.12.2018 |
|---|---|---|
| Tatim Fitimi | 15% | 15% |

## 9. Dividende

Shoqeria synon te njohe dividendet si detyrim ne periudhen ne te cilen jane deklaruar.

## 10. Kapitali i Vet

Kapitali i nenshkruar perfaqeson kontributin e ortakeve në daten e krijimit të shoqerise dhe ndryshimet gjate veprimtarise.
Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

## 11. Përfitimet e punonjesve

*Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

## 12. Ngjarje pas mbylljes se Pasqyrave Financiare

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese te Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

13. **Mjetet Monetare** Gjendja e likuiditeteve ne 31.12.2019 paraqitet si me poshte krahasuar me 31.12.2018

| | | 31 Dhjetor 2019 | | 31 Dhjetor 2018 | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Llogarite Bankare Sipas bankave** | Monedha | **Ekuivalenca ne leke** | **Vlefta** | **Ekuivalenca ne leke** | **Vlefta** |
| RAIFFEISEN LEK | LEK | 782,718 | | 322,684 | |
| BKT LEK | LEK | 3,679,973 | | 299,975 | |
| TIRANA LEK | LEK | - | | - | |
| INTTENSA LEK | LEK | 526,615 | | (189) | |
| CREDINS LEK | LEK | - | | - | |
| PROCREDIT LEK | LEK | 12,374,045 | | 1,980,449 | |
| UNION BANK | LEK | 361,039 | | 63,044 | |
| FIBANKALL | LEK | 0 | | 400,966 | |
| RAIFEISEN EURO | EUR | 341,883 | € 2,807.61 | 58,549 | € 474.39 |
| BKT EURO | EUR | 6,622 | € 54.38 | 2,392 | € 19.38 |
| TIRANA EURO | EUR | - | € - | (357) | € (2.89) |
| INTENSA EURO | EUR | 26 | € 0.21 | 31 | € 0.25 |
| CREDINS EURO | EUR | - | € - | - | € - |
| ALPHA EURO | EUR | - | € - | | |
| PROCREDIT EURO | EUR | 8,671,182 | € 71,209.51 | 10,961,092 | € 88,811.31 |
| UNION BANK EURO | EUR | - | € - | - | € - |
| RFAISENEUROOVER | EUR | 0 | € 0.00 | 0 | € (0.00) |
| FIBANKEURO | EUR | 0 | € 0.00 | (2,291) | € (18.56) |
| INTESAOVERDRAFTEURO | EUR | (1,003) | € (8.24) | (1,017) | € (8.24) |
| RAIFFEISEN DOLLARE | USD | (940) | $ (8.65) | (1,210) | $ (11.22) |
| Alpha Dollare | USD | - | $ - | (8,820) | $ (81.80) |
| BKT DOLLARE | USD | 2,146 | $ 19.75 | 5,623 | $ 52.15 |
| PROCREDIT DOLLARE | USD | 33,122 | $ 304.88 | 1,496,184 | $ 13,876.68 |
| **Totali** | | **26,777,427** | | **15,577,105** | |

| | | 31 Dhjetor 2019 | | 31 Dhjetor 2018 | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mjete monetare banke** | Monedha | **Ekuivalenca ne leke** | Vlefta | **Ekuivalenca ne leke** | Vlefta |
| Llogari rrjedhese | Leke | 17,724,391 | - | 3,066,928 | - |
| Llogari rrjedhese | EURO | 9,018,709 | ######## | 11,018,399 | ######## |
| Llogari rrjedhese | USD | 34,328 | $ 315.98 | 1,491,777 | $61,511.30 |
| **Totali** | | **26,777,427** | | **15,577,105** | |

| | | 31 Dhjetor 2019 | | 31 Dhjetor 2018 | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mjete monetare ne arke** | Monedha | **Ekuivalenca ne leke** | - | **Ekuivalenca ne leke** | - |
| Arka Ne LEK | Leke | 5,792,836 | | 12,620,169 | |
| ARKA EURO | Leke | 21,919 | € 180.00 | | |
| | | **5,814,651** | | **12,620,169** | |

Veprimet e levizjeve monetare ne librat e arkes dhe bankes, jane veprime te autorizuar, mbeshteten ne dokumenta qe jusifikojne pagesat dhe arketimet, regjistrimet jane kronologjike. Per gjendjen ne valute eshte bere rivleresimi me kursin fiks te bankes Shqiperise ne daten 31.12.2019 dhe diferencat jane pasqyruar ne rezultatin e shoqerise.

Import - Export SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

14. **Te drejta te Arketueshme Afatshkurter.** Gjendja e te drejtave te arketueshme ne 31.12.2019 paraqitet si me poshte krahasuar me 31.12.2018

| Kerkesa te arketueshme | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Nga aktiviteti i shfrytëzimit(KLIENTE' | Leke | 66,394,113 | 57,266,799 |
| Llogari/kerkesa te arketueshme | | 643,621,433 | 682,268,076 |
| **Totali** | | **710,015,546** | **739,534,875** |

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit eshte perfshire detyrimi i klienteve ne 31.12.2019 te cilat do te arketohen ne vazhdim.

Ne zerin te tjera te arketueshme perfshihen vlerat si me poshte:

**Llogari/Kerkesa te arketueshme**

| Te tjera kerkesa te arketueshme | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Tatim Fitimi | Leke | 1,225,837 | |
| Llogaria e Ortakut | Leke | 606,325,731 | 636,310,756 |
| Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë | Leke | 31,640,559 | 41,640,559 |
| Shteti TVSH per tu rregulluar | Leke | 379,872 | 65,840 |
| Parapagime te tjera | Leke | 4,049,433 | 4,250,921 |
| **Totali** | | **643,621,433** | **682,268,076** |

## 15. Inventaret

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Inventaret te dates 31.12. 2019 krahasuar me 31.12.2018:

| Inventare | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Lendet e para | Leke | 20,350,718 | 33,640,218 |
| Prodhimi ne proces | Leke | 0 | 0 |
| Produkte te gatshme | Leke | 14,832,013 | 14,738,179 |
| Mallra per rishitje | Leke | 10,817,388 | 8,710,203 |
| Parapagime per furnizime | Leke | 0 | 30,464 |
| **Totali** | | **46,000,119** | **57,119,063** |



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

## 16. Te drejta te Arketueshme Afatgjate

| Te tjera kerkesa te arketueshme Afatgjate | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Parapagime Detyrime Tatime (gjoba,detyrime) viti 2007 | Leke | 63,922,001 | 63,922,001 |
| **Totali** | | **63,922,001** | **63,922,001** |

SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

1. Aktivet Materiale dhe Jo-materiale Afatgjate

| Vlera Bruto | Toka | Ndertesa | Impiante dhe makineri | mjete | Te tjera instalime dhe paisje | aktive materiale dhe ne proces | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 Dhjetor 2018 | 34,580,000 | 100,801,500 | 295,686,722 | 49,624,880 | 16,596,912 | 2,791,041 | 500,081,054 |
| Shtesa | | | 16,828,716 | | 2,434,893 | | 19,263,609 |
| Transferime | | | | 0 | | | 0 |
| Pakesime | | | | 0 | | | 0 |
| 31 Dhjetor 2019 | 34,580,000 | 100,801,500 | 312,515,438 | 49,624,880 | 19,031,805 | 2,791,041 | 519,344,663 |
| **Amortizimi Akumuluar** | | | | | | | |
| 31 Dhjetor 2018 | 0 | 35,009,972 | 194,487,692 | 26,973,139 | 11,101,294 | 0 | 267,572,097 |
| Shtesa | 0 | 3,289,576 | 21,781,964 | 4,530,348 | 1,713,470 | | 31,315,358 |
| Pakesime | | | | 0 | 0 | | 0 |
| 31 Dhjetor 2019 | 0 | 38,299,548 | 216,269,656 | 31,503,487 | 12,814,764 | 0 | 298,887,455 |
| **Vlera Neto** | | | | | | | |
| 31 Dhjetor 2018 | 34,580,000 | 65,791,529 | 101,199,030 | 22,651,741 | 5,495,618 | 2,791,041 | 232,508,957 |
| 31 Dhjetor 2019 | 34,580,000 | 62,501,953 | 96,245,782 | 18,121,393 | 6,217,041 | 2,791,041 | 220,457,208 |
| | | | | | | | 220,457,208 |

| Vlera Bruto | Markat |
|---|---|
| 31 Dhjetor 2018 | 630,611 |
| Shtesa | |
| Transferime | |
| Pakesime | |
| 31 Dhjetor 2019 | 630,611 |
| **Amortizimi Akumuluar** | |
| 31 Dhjetor 2018 | 413,664 |
| Shtesa | 32,542 |
| Pakesime | |
| 31 Dhjetor 2019 | 446,206 |
| **Vlera Neto** | |
| 31 Dhjetor 2018 | 216,947 |
| 31 Dhjetor 2019 | 184,405 |

2.

17. **Detyrimet afatshkurtra** Detyrimet afatshkurtes ne 31.12.2019 krahasuar me dt 31.12.2018 paraqiten si me poshte:

| Huate dhe Parapagimet | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Detyrime ndaj institucioneve të kredis | Leke | 18,366,103 | 19,225,517 |
| Furnitore per tu paguar | Leke | 193,554,852 | 229,940,981 |
| Te pagueshme-Personeli | Leke | 260,408 | 229,688 |
| Detyrime tatimore | Leke | 7,552,904 | 6,064,656 |
| Të tjera të pagueshme | Leke | 36,191,586 | - |
| **Totali** | | **255,925,853** | **255,460,842** |

Detyrime ndaj institucioneve te kredise eshte kredi per tu likujduar gjate vitit ushtrimor.

| Huate dhe obligacionet afatshkurtra | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Ekuivalenca ne leke | Valute | 31 Dhjetor 2018<br>Ekuivalenca ne leke | Valute |
|---|---|---|---|---|---|
| KREDI PROCREDIT | Euro | 13,676,101 | € 112,310.92 | 14,925,519 | € 120,932.74 |
| BLERJE ME LIZING | Euro | 4,690,002 | € 38,515.25 | 4,299,998 | € 34,840.37 |
| **Totali** | | **18,366,103** | | **19,225,517** | |

Te pagueshme per detyrime tatimore paraqitet si me poshte:

| Detyrime ndaj buxhetit | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | Leke | 746,481 | 906,668 |
| Tatim mbi pagat | Leke | 380,744 | 440,803 |
| Tatim ne Burim | Leke | - | - |
| Tatim fitmi | Leke | - | 330,649 |
| Tvsh per tu paguar | Leke | 6,425,679 | 4,386,536 |
| **Totali** | | **7,552,904** | **6,064,656** |

18. **Detyrime aftagjata** ne 31.12.2019 krahasuar me 31.12.2018 paraqiten si me poshte

| Huate dhe obligacionet afatshkurtra | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Ekuivalenca ne leke | Valute | 31 Dhjetor 2018<br>Ekuivalenca ne leke | Valute |
|---|---|---|---|---|---|
| KREDI PROCREDIT | Euro | 61,451,771 | € 504,653.00 | 76,146,689 | € 616,972.04 |
| BLERJE ME LIZING | Euro | 10,043,848 | € 82,482.12 | 15,646,028 | € 126,770.60 |
| **Totali** | | **71,495,619** | | **91,792,717** | |

Detyrime ndaj institucioneve te kredise eshte kredi afatgjate. Kredia likujdohet rregullisht dhe nuk ka vonesa ne likujdim

Import - Export
SH.P.K.
VALTELINA
NIPT J 61923012 V
TIRANE - ALBANIA

## 19. Provizione Afatgjate

| Provizione të tjera | Monedha | 31 Dhjetor 2019 Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018 Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Provizione te tjera | Leke | - | - |
| **Totali** | | **-** | **-** |

## 20. Kapitali dhe Rezervat

*Kapitali Regjistruar*

**31.12.2019**

| | Nr.Pjeseve | Vlera nominale e aksionit | Struktura e Kapitalit regjistruar | Kapitali i aksionar |
|---|---|---|---|---|
| Vjollca Hoxha | 7.25 | 3,000,000.00 | 7.25% | 21,750,000.00 |
| Lorela Hoxha | 7.25 | 3,000,000.00 | 7.25% | 21,750,000.00 |
| Sara Hoxha | 7.25 | 3,000,000.00 | 7.25% | 21,750,000.00 |
| Redia Hoxha | 7.25 | 3,000,000.00 | 7.25% | 21,750,000.00 |
| Itan Hoxha | 20.00 | 3,000,000.00 | 20.00% | 60,000,000.00 |
| EM CAPITAL GROUP AD | 51.00 | 3,000,000.00 | 51.00% | 153,000,000.00 |
| | **100.00** | | **100%** | **300,000,000** |

*Kapitali paregjistruar prej 82,350,000 Leke, sipas Vendimit te ortakut .*
*Rezerva te tjera per investime 314,760,890 leke.*
*Fitim /(humbje) vitit per 48,638,995 Leke.*

Veprimet ne llogarit e kapitalit jane te mbeshtetura me dokumenta ligjore.

21. **Të Ardhurat nga shitja** Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. Te ardhura matet me vlere te drejte te mallit/sherbimit te shitur neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

| Te ardhurat | Monedha | 31 Dhjetor 2019 Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018 Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| *Te ardhurat nga aktiviteti kryesor* | Leke | 399,364,272 | 430,789,046 |
| *Të ardhura të tjera të shfrytëzimit* | Leke | 19,900,332 | 18,316,293 |
| **Totali** | | **419,264,605** | **449,105,339** |

Ne total diferenca midis te ardhurave te deklaruara me FDP dhe te ardhurave te deklaruara ne pasqyrat financiare eshte 0 leke.Te ardhurat e deklaruara me FDP jane 419,264,605 leke dhe te ardhurat ne bilanc jane 419,264,605 leke , shtuar me ndryshimin e gjendjes se produktit te gatshem per 1,297,230 leke



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

**Shpenzime**

Shoqëria njeh shpenzimet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me kryerjen e tyre ne datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës se tyre, çka kërkon gjykim te konsiderueshëm nga drejtimi i Shoqërisë.

## 22. Mateliale te konsumuara

| Mallra , lende te para dhe sherbime | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Materiale te konsumuara | Leke | (171,894,960) | (178,743,894) |
| **Totali** | | **(171,894,960)** | **(178,743,894)** |

Materiale te konsumuara perfaqeson koston e lendes se pare te perdorur ne prodhim dhe kosto e mallrave per rishitje.

## 23. Shpenzime per Personelin

| Shpenzimet e Personelit | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Shpenzimet per pagat | Leke | (42,172,269) | (41,268,063) |
| Sigurimet shoqerore shendetsore | Leke | (6,994,034) | (6,565,905) |
| **Totali** | | **(49,166,303)** | **(47,833,968)** |

Numri i punonjësve: *68,*

Shpenzimet e punësimit (pagat dhe sigurimet shoqërore & shëndetësorë) janë dokumentuar dhe paraqitur ne shpenzimet për personelin, gjithashtu edhe detyrimet fiskale te punëmarrësit ne lidhje me pagën e përfituar janë dokumentuar dhe paraqitur sakte ne Pasqyrat Financiare.

## 24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

| Amortizimi | Monedha | 31 Dhjetor 2019<br>Vlera ne leke | 31 Dhjetor 2018<br>Vlera ne leke |
|---|---|---|---|
| Amortizimi dhe Zhvleresimet | Leke | (31,347,900) | (29,837,688) |
| **Totali** | | **(31,347,900)** | **(29,837,688)** |

SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

## 25. Shpenzime te tjera te shfrytezimit

*Shpenzimet te tjera te shfrytezimit ne 31.12.2019 krahasuar me 31.12.2018 jane si me poshte:*

| | | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Shpenz. Te tjera nga vep.e shfrytezimit** | Monedha | **Vlera ne leke** | **Vlera ne leke** |
| Shpenzime energji elektrike | Leke | (1,389,182) | (1,906,012) |
| Shpenzime Furnitura te tjera | Leke | (12,536,733) | (20,968,931) |
| Shpenzime Qira Ambientesh | Leke | - | (3,253,847) |
| Shpenzime Prime sigurimi | Leke | (1,472,632) | (1,380,563) |
| Shpenzime Te tjera | Leke | (35,504,488) | (12,422,153) |
| Shpenzime Reklama | Leke | (18,488,635) | (20,496,959) |
| Shpenzime Telefonie | Leke | (1,951,716) | (2,860,371) |
| Shpenzime udhetime dieta | | (921,026) | (1,023,000) |
| Shpenzime Transporti | Leke | (7,012,571) | (8,596,303) |
| Shpenzime Taksa vendore | Leke | (23,212,699) | (25,089,088) |
| Shpenzime Gjoba | Leke | - | (1,214,438) |
| Shpenzime bankare | Leke | (285,394) | (337,515) |
| **Totali** | Leke | **(102,775,076)** | **(99,549,181)** |

## 26. Te Ardhura dhe Shpenzime Financiare (Neto)

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metodën e interesit efektiv.

| | | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Te ardhurat dhe shpenz. Financiare** | Monedha | **Vlera ne leke** | **Vlera ne leke** |
| Te ardhura dhe shpenzime nga interesat | Leke | (5,049,640) | (5,310,581) |
| Fitimet (Humbjet) nga kursi i kembimit | Leke | 2,093,235 | 8,572,303 |
| Te ardhura dhe shpenzime te tjera financia | Leke | - | - |
| **Totali** | | **(2,956,405)** | **3,261,723** |

***Fitime humbje nga kursi i kembimit jane si me poshte***

| | | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| ***Rezultati nga kursi i kembimit*** | Monedha | ***Vlera ne leke*** | ***Vlera ne leke*** |
| *Te ardhura nga diferencat e kursit* | Leke | *2,130,492* | *8,905,470* |
| *Shpenzime nga diferencat e kursit* | Leke | *(37,257)* | *(333,167)* |
| ***Totali*** | | ***2,093,235*** | ***8,572,303*** |



SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE - ALBANIA

***Tatimi mbi Fitimin***

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël te tatimit për t'u paguar ne lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 dhe 2018 paraqiten me poshtë:

| | 31.12.2019 | 31.12.2018 |
|---|---|---|
| Tatim Fitimi | 15% | 15% |

**27. Rezultatit Tatimore dhe Fitimi Neto**

| | | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Rezultati tatimor** | Monedha | **Vlera ne leke** | **Vlera ne leke** |
| **Fitimi para tatimit** | Leke<br>Leke | **62,421,190** | **92,415,425** |
| Shpenzime te panjohura | Leke | 29,460,113 | 9,456,292 |
| **Fitimi fiskal** | Leke | **91,881,303** | **101,871,717** |
| **Tatim fitimi (15 %)** | Leke | **(13,782,195)** | **(15,280,758)** |
| **Fitimi Neto** | | **48,638,995** | **77,134,667** |

**28. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara**

*Çështje gjyqësore*

Me 31 Dhjetor 2019 Shoqeria ka çështje gjyqesore te hapur kundrejt Drejtorise se Tatimeve me objekt kundershtimin e raport-kontrolli por te pa provizionuar.

***Detyrime tatimore***

Librat e Shoqerise nuk jane kontrolluar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019.Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

**29. Ngjarje pas dates se bilancit**

Me 31 Dhjetor 2019 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.

**Administratori** — **Hartuesi i Pasqyrave Financiare**

**Vjollca Hoxha** — **Rudina Qurku**

Vjollca Hoxha

SH.P.K. VALTELINA NIPT J 61923012 V TIRANE ALBANIA

ALBANIAN BUSINESS TRANSPARENCY

**Tirane, më 31/03/2020**